

Pasqyrat Financiare te Shoqerise
«ALBANIAN DIGITAL PRINTING SOLUTIONS & SERVICES » Shpk

Se bashku me Raportin e Audituesit te Pavarur

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	1
BILANCI KONTABËL	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 19

1. RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimt dhe Ortakeve të Albanian Digital Printing Services & Solutions Sh.p.k.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë **Albanian Digital Printing Services & Solutions Sh.p.k.** (më poshtë "Shoqëria") që përmbajnë bilancin kontabël më datë 31 Dhjetor 2014 si dhe pasqyrën përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë ushtrim, pasqyrën e fluksit të parase dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitaleve të veta, dhe të tjera shënime sqaruese.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tone në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albanian Digital Printing Services & Solutions Sh.p.k.** japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2014 si dhe të rezultateve të aktivitetit të saj për ushtrimin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit.

Luan Kamberi
Partner Angazhimi



26 Mars, 2015

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2014

AKTIVE	Shenime	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	1,868,174	132,249
Llogari të arkëtueshme	5	23,694,337	24,506,713
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	6	998,089	1,318,164
Inventari	7	9,785,104	6,414,868
Aktive të tjera afatshkurtra	8	19,195	273,015
Total Aktiveve Afatshkurtra		36,364,899	32,645,009
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	32,971,146	37,361,932
Aktive afatgjatë jomateriale	10	73,941	54,714
Llogari të tjera të arkëtueshme		-	-
Total aktive afatgjatë		33,045,087	37,416,646
Total Aktive		69,409,986	70,061,655
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	1,394,613	1,085,455
Llogari të pagueshme tregëtare	12	33,760,443	36,416,834
Parapagimet e arkëtueshme		-	-
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime		-	-
Llogari të pagueshme të tjera	13	2,886,190	1,609,973
Total Detyrime afatshkurtra		38,041,246	39,112,262
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	14	12,422,519	16,677,706
Tatimi i shtyre mbi fitimin		-	-
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime		-	-
Detyrime të tjera afatgjatë	15	5,465,462	5,467,801
Total Detyrime afatgjatë		17,887,981	22,145,507
Totali i detyrimeve		55,929,227	61,257,769
Kapitali themeltar			
Kapitali themeltar	16	100	100
Reduktim i paregjistruar i kapitalit		-	-
Rezerva të tjera		8,803,776	861,726
Rezerva ligjore		10	10
Fitime të mbartura		-	-
Fitimi i ushtrimit		4,676,873	7,942,050
Total kapitalit		13,480,759	8,803,886
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		69,409,986	70,061,655

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

		Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
	Shenime		
Te ardhura	17	115,542,481	95,684,594
Te ardhura te tjera		-	-
Ndryshimet ne inventarin e produktit te gatshem		63,059	(657,228)
		-	-
Materiale te para dhe te konsumueshme	18	(69,909,360)	(59,150,004)
Shpenzime personeli	19	(25,408,590)	(15,352,572)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	9/10	(7,460,335)	(5,725,399)
Shpenzime te tjera	20	(4,733,798)	(4,126,883)
Fitimi operativ		8,093,457	10,672,508
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara		-	-
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	21	(1,803,795)	(1,734,668)
Total shpenzime financiare		(1,803,795)	(1,734,668)
Fitimi para tatimit		6,289,662	8,937,840
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		-	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(1,612,789)	(995,790)
Fitimi i vitit		4,676,873	7,942,050

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BRAMAC SISTEMI PER ÇATI SH.P.K.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali themeltar	Rezerva te tjera	Rezerva ligjore	(Humbje) Ushttrim	Fitim	Totali
01 Janar 2013	100	-	10	861,726		861,836
Fitimi i vitit						
Transferim ne rezerva te tjera				7,942,050		7,942,050
Dividendë te paguar		861,726		(861,726)		-
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse:						-
31 Dhjetor 2013	100	861,726	10	7,942,050		8,803,886
Transferim ne rezerva te tjera						
Fitimi i vitit		7,942,050		(7,942,050)		-
Pakesim i rezervave ligjore				4,676,873		4,676,873
Dividendë te paguar						-
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse:						-
31 Dhjetor 2014	100	8,803,776	10	4,676,873		13,480,759

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.
 Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u nënshkruan si më poshtë më 06 Mars 2015 nga:

Elvis Sula
 Administrator

Mazars shpk
Enilda Xheqaj



Pasqyra e Fluksit të Parasë
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	<u>Dhjetor 31, 2014</u>	<u>Dhjetor 31, 2013</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	6,289,662	8,937,840
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7,460,335	5,725,399
Te ardhura nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale		
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi kapital		
Pakësimi i rezervave		
Interesa te perlogaritura		
Shpenzime për interesa	1,744,055	1,307,300
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues		
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar	(3,370,236)	(1,529,196)
Ndryshimi në llogari te arketueshme dhe te tjera	908,026	(10,341,708)
Ndryshimi në llogari te pagueshme dhe te tjera	(1,620,080)	8,418,600
Ndryshimi në parapagime e shpenzime te shtyra	320,075	(407,491)
Ndryshimi në te ardhura te shtyra	-	
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	11,731,837	12,110,744
Interesa te paguara	(1,744,055)	(1,307,300)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(1,214,711)	(632,401)
	(2,958,766)	(1,939,701)
Aktivitetet investuese		
Blerje te aktiveve afatgjata material	(3,088,777)	(14,939,152)
Shitje e aktiveve afatgjata material		
Blerje e shoqërisë së kontrolluar minus parate e arketuara		
Interesa të marra		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(3,088,777)	(14,939,152)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huatë agjatgjata	(2,339)	23,790
(Ripagim)/ te hyra nga hua afatshkrter	309,158	1,085,455
Shtesa/pakesime në qera financiare	(4,255,187)	3,739,959
Dividendë paguar		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(3,948,368)	4,849,204
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	1,735,926	81,094
Mjetet monetare në fillim të periudhës	132,249	51,155
Mjetet monetare në fund të periudhës	1,868,174	132,249

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

2. TË PËRGJITHSHME

"Albanian Digital Printing Solutions & Services" sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 18 Mars 2011 ne përputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë tregtare".

Kapitali i nenshkruar i shoqërisë është 100 Lek, i ndare në 100 njësi të barabarta me nga 1 leke secila.

Ortakët e shoqërisë janë :

- Z. Elvis Sula zotues i 24.5 kuotave ose 24.5% të kapitalit të shoqërisë
- Wildermore Holdings zotues i 24.5 kuotave ose 24.5% të kapitalit të shoqërisë
- INFORM P.LYKOS S.A PROCESSING & DEVELOPMENT OF PRINTED INFORMATIONS SYSTEMS zotues i 51 kuotave ose 51% të kapitalit të shoqërisë)

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje shtypshkrime dixhitale dhe menaxhim i të gjitha llojeve të dokumenteve dhe shtypshkrimeve. Tregti e të gjitha produkteve të ngjashme dhe makinerive që lidhen me këtë lloj aktiviteti. Shtypshkrim dhe menaxhim i dokumenteve me elemente sigurie. Perfaqësim në Shqipëri i shoqërive të huaja me aktivitet të ngjashëm. Prodhim, tregtim, perfaqësim i elementeve të programeve kompjuterike (software tools) si dhe zgjidhje të ndryshme të karakterit software.

Sella e shoqërisë është në adresën: Autostrada Tirane-Durres, Km. 5, Kashar Tirane

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria kishte 16 punonjës (2013: 20 punonjës).

3. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", Shoqëria ka vendosur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

4. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flusit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete Transporti	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare (vazhdim)

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likujditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe ato që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Mjete monetare në banke	1,667,694	121,495
Llogari rrjedhese	1,667,694	121,495
Depozita me afat	-	-
Mjete monetare në arke	200,480	10,754
Totali	1,868,174	132,249

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kliente	23,694,337	24,506,713
	23,694,337	24,506,713

6. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

Ne kete ze jane paraqitur shpenzime per sigurime dhe shpenzime pershtatje ambjenti te cilat i perkasin periudhave te ardhëshme.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime te shtyra	998,089	1,318,164
Totali	998,089	1,318,164

7. INVENTARI

Inventari më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 eshte si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Lende e pare dhe materiale	9,001,622	6,111,971
Mallra per rishitje	720,423	302,897
Produkt i gatshem	63,059	-
Totali	9,785,104	6,414,868

8. LLOGARI TË TJERA TE ARKËTUESHME

Llogaritet e tjera te arketueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shteti TVSH për tu rregulluar	1,100	-
Detyrime doganore	18,095	15,581
Tatim Fitimi	-	158,172
Te tjera	-	99,262
Totali	19,195	273,015

(Vlerat janë në Lek)

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Te tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	32,754,295	-	-	2,619,522	753,691	36,127,509
Shtesa	14,276,177			146,071	458,540	14,880,788
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	47,030,472	-	-	2,765,593	1,212,232	51,008,297
Shtesa		953,836	52,167	97,311	1,957,481	3,060,794
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	47,030,472	953,836	52,167	2,862,904	3,169,713	54,069,091
Zhvlerësimi i akumuluar						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	7,625,797	-	-	234,324	64,495	7,924,616
Amortizimi i vitit	4,923,584			611,519	186,646	5,721,749
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	12,549,381	-	-	845,843	251,141	13,646,365
Amortizimi i vitit	6,494,474	158,970	11,333	492,842	293,961	7,451,580
Nxjerrje jashtë përdorimit						-
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	19,043,855	158,970	11,333	1,338,685	545,102	21,097,945
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	25,128,498	-	-	2,385,198	689,196	28,202,893
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	34,481,091	-	-	1,919,750	961,091	37,361,932
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	27,986,617	794,866	40,834	1,524,219	2,624,611	32,971,146

10. AKTIVE AFATGJATA JO MATERIALE

	<u>AAJM</u>	<u>Total</u>
Me kosto		
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	58,364	58,364
Shtesa	27,983	27,983
Pakesime	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	86,346	86,346
Amortizimi		
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	3,650	3,650
Amortizimi i vitit	8,755	8,755
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	12,405	12,405
	-	-
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2013	54,714	54,714
Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2014	73,941	73,941

11. HUA AFATSHKURTRA

Në këtë zë është paraqitur overdrafti nga banka si me poshte më 31 dhjetor 2014 dhe 2013

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Overdraft Raiffeisen Bank	1,394,613	1,085,455
	1,394,613	1,085,455

12. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve si me poshtë me 31 dhjetor 2014 dhe 2013.

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Furnitore vendas	9,457,591	10,179,115
Furnitore te huaj	24,199,327	26,026,611
Furnitore per fatura te pa mberitura	103,525	211,108
	33,760,443	36,416,834

13. DETYRIME TE TJERA

Detyrimet te tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paga per t'u paguar	718,739	685,156
Sigurime shoqerore & shendetesore	261,776	242,511
Tatimin mbi te ardhurat personale	665,331	124,426
Tatim ne burim	185,321	136,921
TVSH per t'u paguar	378,864	21,106
Tatim fitimi	239,906	-
Pefitime afatshkurta nga sigurimet	36,394	-
Debitore & kreditore te tjere	399,859	399,853
	<u>2,886,190</u>	<u>1,609,973</u>

14. HUA AFATGJATA

Në këtë ze eshte paraqitur qeraja financiare më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Qera Finaciare Raiffeisen Leasing	11,849,538	16,677,706
Qera Finaciare Porsche Leasing	572,981	-
	<u>12,422,519</u>	<u>16,677,706</u>

15. DETYRIME TE TJERA AFATGJATA

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Finacim Elvis Sula	2,732,731	2,733,900
Finacim Kostas Grekis	2,732,731	2,733,901
	<u>5,465,462</u>	<u>5,467,801</u>

16. KAPITALI THEMELTAR**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 100 Leke. Gjate vitit 2014 nuk ka pasur ndryshim ne kapitalin e shoqerise.

17. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga shitja e produktit te vet	87,776,993	88,965,003
Te ardhura nga shitja e mallrave	16,002,045	3,566,085
Te ardhura nga sherbimet	11,763,443	3,153,506
	115,542,481	95,684,594

Me poshte analizohet rakordimi i te ardhurave te deklaruar ne Pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve dhe ato te deklaruar ne FDP –ne e TVSH-se dhe Tatim Fitimit:

	Dhjetor 31, 2014
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne e Tatim Fitimit	
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	120,072,259
Zbriten Autofaturimet 2014	(4,529,778)
Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH	115,542,481
Fitim nga kembimet valutore	114,206
Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Fitimit	115,656,687

18. MATERIALE TE PARA SHERBIME

Kosto e materialeve te para dhe te tjera te konsumueshme per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Kosto e materialeve te para	38,062,761	41,057,104
Kosto e materialeve te ambalazhimit	700,189	860,736
Pjese kembimi	6,384,250	5,121,011
Materiale te tjera ndihmese	55,489	157,436
Kosto e mallrave te shitur	13,997,708	2,882,731
Nenkotraktore	2,242,054	1,877,967
Mirembajtje dhe riparime makinerite dhe fabrika	3,117,456	2,732,674
Qera	2,994,011	2,989,346
Prime sigurimi	196,586	128,868
Energji elektrike	1,239,939	1,342,131
Sherbime nga te trete	918,917	-
	69,909,360	59,150,004

19. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Shpenzime per paga	20,520,713	13,751,464
Shpenzime per sigurime shoq e shend	1,892,383	1,469,059
Qera apartamenti per punonjesit	1,618,799	126,383
Shpenzime te tjera per punonjesit	1,376,695	5,666
	25,408,590	15,352,572

20. SHPENZIME TË TJERA

Këto shpenzime janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Shpenzime qeraje	28,090	336,900
Mirëmbajtje dhe riparime	255,300	139,808
Shpenzime per licence software, konfigurim , setup	134,809	757,966
Shpenzime administrative dhe noteriale	75,763	44,833
Konsulenca ekonomike dhe juridike	802,492	772,684
Sherbime nga te trete	805,760	51,359
Blerje te ndryshme,kancelari etj	276,867	210,307
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	552,027	303,685
Komisione bankare	265,679	261,729
Shpenzime udhetimi dhe dieta	125,953	52,621
Dhurata	21,000	-
Taksa te ndryshme	20,320	20,120
Gjoha te ndryshme	15,614	25,824
Kosto udhetimi dhe akomodimi tekniket	633,948	708,265
Shpenzime te ndryshme dhe te panjohura	720,176	440,782
	4,733,798	4,126,883

21. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare janë analizuar si me poshte:

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Shpenzime per interesa	(1,744,055)	(1,318,973)
Te ardhura nga interesat	-	11,672
Humbje nga kembimet valutote	(173,946)	(467,667)
Te ardhura nga kembimet valutore	114,206	40,300
	(1,803,795)	(1,734,668)

22. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të fitimin në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Fitimi para tatimit	6,289,662	8,937,840
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	4,462,268	1,020,063
Shpenzime pritje & percjellje	21,000	
Shpenzime udhetimi	1,370,695	22,402
Penalitet, gjoba e demshperblime	15,614	25,824
Shpenzime interesash te panjohura	225,116	145,948
Shpenzime te tjera	2,829,843	825,889
Fitimi Tatimor	10,751,930	9,957,903
Humbje fiskale e mbartur		
	10,751,930	9,957,903
Tatim fitimi 15%	1,612,789	995,790
	4,676,873	7,942,050

Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin:

	Dhjetor 31, 2014	%	Dhjetor 31, 2013	%
Fitimi per vitin	6,289,662	100%	8,937,840	100%
Tatim fitimi me normen e aplikueshme	943,449	15%	893,784	10%
<i>Rregullime per diferenca te perhershme:</i>				
Shpenzime pritje & percjellje	3,150	0%	-	0%
Shpenzime udhetimi	205,604	3%	2,240	0%
Penalitet, gjoba e demshperblime	2,342	0%	2,582	0%
Shpenzime interesash te panjohura	33,767	1%	14,595	0%
Shpenzime te tjera	424,475	7%	82,589	1%
	-		-	
Totali	1,612,789	25.64%	995,790	11.14%

23. TRANSAKSIONE ME PALË TË LIDHURA

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë të detajuara si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Bilanci kontabël		
Të pagueshme nga palët e lidhura		
Inform P.Lykos SA	21,929,291	23,755,681
Elvis Sula	2,732,730	2,733,900
	24,662,021	26,489,581
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura		
Inform P.Lykos SA	4,853,035	-
	4,853,035	-
Blerje nga palët e lidhura	34,465,415	23,453,164
Inform P.Lykos SA	34,465,415	23,453,164

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

24. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 Dhjetor 2014, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

25. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.